



Pranuar / Dorezuar Punimjen/Prodato Received/Delivety	20.11.2023	3	viti god year
Organ /Njesia Organ /Jedintca Org./Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKIMSHCK	7037/2023		117



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.1211/2023

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës–Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave i përbërë nga: Malsore Gashi-Bajraktari-kryetare Arben Mehmeti, dhe Eshref Shabani-anëtarë, me Ilire Mehmeti-Shaqiri-Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional, në cilësinë e procesit ajtësit, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.1211/2023 të datës 26.09.2023 të ankueses _____ të cilin më autorizim e përfaqëson Avokat _____ me adresë rruga "Fehmi Agani", Hyrja 154, Kati I, Nr. 8 në Prishtinë, kundër Vendimit KA.Nr.30/2023 të datës 06.09.2023 të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Sekretariatit të Këshillit Prokurorial të Kosovës, në çështjen juridike "shkelje e të drejtës në pagë", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, nenin 16 paragrafi 3 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 dhe 1.6 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 17.11.2023, mori këtë:

V E N D I M

- I. Refuzohet si e pabazuar ankesa me numër A.nr.1211/2023 e datës 26.09.2023 e parashtruar nga ankuesja
- II. Mbetet në fuqi pika I e dispozitivit të Vendimit KA.Nr.30/23 të datës 06.09.2023 të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Sekretariatit të Këshillit Prokurorial të Kosovës së bashku me arsyetimin për këtë pikë
- III. Shfuqizohet pika II e dispozitivit të Vendimit KA.Nr.30/23 të datës 06.09.2023 të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Sekretariatit të Këshillit Prokurorial të Kosovës së bashku me arsyetimin për këtë pikë.

Arsyetim

Ankuesja, _____ e punësuar në Sekretariatit të Këshillit Prokurorial të Kosovës sipas Akt Emërimit Nr. protokollit ZBNJ/DP-057/2013 të datës 01.07.2013 në pozitën „Zyrtare e Larte për Bazë të Dhënave“ në Njësinë për Shqyrtimin e Performances se Prokurorive-NjSHPP më datë 02.02.2023 U.D e Drejtorit të Njësisë për Shqyrtimin e Performances se Prokurorive-NjSHPP përmes e-mailit njofton gjithë vartësit e saj përfshirë edhe ankuesen lidhur me klasifikimin e pozitave të punës sipas koeficientit, ku në mënyrë tabelare pozita e ankueses është klasifikuar në profesional 1 me koeficient 5.85. Ankuesja për muajin shkurt dhe mars 2023 është paguar me koeficient të pagës 9.4, ndërsa nga muaji prill 2023 është paguar me koeficient të pagës 5.85, kështu që më datë 02.05.2023 ankuesja përmes e-mailit ka kërkuar nga Udhëheqësja e Burimeve Njerëzore që të njoftohet se si është bërë zbritja e koeficientit. Ndërsa kjo e fundit me të njëjtën datë i është përgjigjur ankueses se Këshilli Prokurorial i Kosovës me datë 19.01.2023 ka marr vendim për klasifikimin e pozitave të punës ndërsa me datën 30 Mars 2023 nga Ministria e Financave dhe Transfereve, përkatësisht Thesari i Kosovës kemi pranuar një njoftim se deri me muajin Shtator të këtij viti lëshimet eventuale rreth pagave, do të korrigjohen.

Ankuesja më datë 10.05.2023 ka parashtruar ankesë në Komisionin për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Sekretariatit të Këshillit Prokurorial të Kosovës. Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Sekretariatit të Këshillit Prokurorial të Kosovës, më datë 06.06.2023 ka nxjerr Vendim KA.Nr.22/2023 me të cilin ka hudhë si të pasafatshme ankesën e ankuesit.

Ankuesja kundër Vendimit KA.Nr.22/23 të datës 06.06.2023 të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Sekretariatit të Këshillit Prokurorial të Kosovës, më datë 04.07.2023 ka parashtruar ankesë me numër protokollit 5010/2023 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës përmes Vendimit A.nr.907/2023 ka shfuqizuar Vendimin KA.Nr.22/23 të datës 06.06.2023 të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Sekretariatit të Këshillit Prokurorial të Kosovës dhe duke e kthyer çështjen në rishqyrtim dhe rivendosje tek ky organ.

Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Sekretariatit të Këshillit Prokurorial të Kosovës, më datë 06.09.2023 ka nxjerr Vendim KA.Nr.30/2023 me të cilin ka refuzuar si të pabazuar ankesën e ankuesit duke lënë në fuqi Vendimin KA.Nr.22/23 të datës 06.06.2023 të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Sekretariatit të Këshillit Prokurorial të Kosovës.

Ankuesja kundër Vendimit KA.Nr.30/23 të datës 06.09.2023 të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Sekretariatit të Këshillit Prokurorial të Kosovës, më datë 26.09.2023 ka parashtruar ankesë me numër protokollit 5010/2023 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

ankesa e ankueses, është e pa bazuar, sepse:

Ankuesja në ankesën e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Vendimit KA.Nr.30/23 të datës 06.09.2023 të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Sekretariatit të Këshillit Prokurorial të Kosovës, pretendon se pozita e ankueses sipas Ligjit për Pagat në Sektorin Publik është dashur të kategorizohet në kategorinë funksionale Ekspert më koeficient të pagës prej 9.4, të cilën e ka marr për muajin shkurt dhe mars 2023;

Në bazë të provave të lëndë Kolegji i Këshillit, ka gjetur se Këshilli Prokurorial i Kosovës më atë 19.01.2023 ka nxjerr Vendim KPK.Nr.115/2023 përmes të cilit ka bërë miratimin e klasifikimit të pozitive sipas Ligjit Nr. 08/L-196 për Pagat në Sektorin Publikë, ku në numrin rendor 41 të listës pozitive e ankuesit është kategorizuar në klasën profesional 1 me klasë të pagës P14 dhe me koeficient 5.85.

Kolegji i Këshillit, marr për bazë provat materiale të lëndës, ka shqyrtuar pretendimet ankimore të ankuesit, ku thekson faktin se Kuvendi i Republikës së Kosovës, me datë 22.12.2022 ka aprovuar Ligjin Nr.08/L-196 për Pagat në Sektorin Publikë, i cili me datë 05.01.2023 është publikuar në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës Nr.1/5 Janar 2023, dhe si rrjedhojë i njëjti hynë në fuqi një (1) muaj pas publikimit në gazetë zyrtare. Me këtë ligj parashihen rregulla dhe kushte tjera për përcaktimin e pagës të të punësuarve në sektorin publikë, duke përfshi edhe koeficientet dhe nivelet e koeficienteve të pagës të cilat ndryshojnë nga rregullat dhe sistemi aktual i pagave, për më tepër ky ligj ka filluar së zbatuari nga muaji shkurt 2023, dhe përgjatë majit shkurt dhe muajit mars të vitit 2023 ankuesja është paguar me koeficient të pagës 9.4.

Meqenëse në sistemin e ri të pagave sipas Ligjit Nr.08/L-196 për Pagat në Sektorin Publikë, janë evidentuar gabimet në procedimin e tyre, atëherë Qeveria e Republikës së Kosovës përmes Vendimit Nr. 04/128, të datës 16.02.2023 ka obliguar institucionet e administratës publike që ta përgatisin klasifikimin dhe grupimin e pozitive të punës në pajtim katalogun e vendeve të punë dhe të bëjnë ekuivalentimin e koeficienteve të ri më koeficientet e vjetër, për këtë më datë 30.03.2023 zëvendësuesi i Drejtorit të Thesarit të Kosovës ka përcjell shkresë për ndryshime në listat e pagesave tek të gjitha Organizatat Buxhetore, me obligimin që Organizatat Buxhetore është e obliguar dhe mbahet përgjegjëse që ndryshmet në listën e pagave të bëhen në harmoni me legjislacionin në fuqi për pagat dhe Ligjin për Ndarje Buxhetore të vitit përkatës, ndërsa pas kësaj në muajin prill është bërë edhe korigjimi i koeficientit nga 9.4 në 5.85 për ankuesin.

Duke marr parasysh që pozita e ankueses kategorizohet në profesional 1, atëherë me dispozitat e Ligjit Nr.08/L-196 për Pagat në Sektorin Publikë, përkatësisht lidhur me pagat e nëpunësve civilë është përcaktuar, si ne vijim:

Neni 1, përcakton se: 1 Qëllimi i këtij ligji është që të krijojë një sistem të njëtrajtshëm të pagave në sektorin publik që përfshin parimet dhe rregullat për përcaktim të pagës në sektorin publik si dhe të krijojë një sistem të pagave dhe shpërblimeve, transparent dhe të menaxhueshëm ku elementi kryesor është paga bazë.

Neni 6 paragrafi 1, përcakton se: "Paga bazë është pjesa fikse e pagës që përfitohet për punën e kryer me orar të plotë apo punën me orar të pjesshëm që konsiderohet si punë me orar të plotë, në një funksion apo pozitë të caktuar që përcaktohet nga grupi dhe klasa e pagës së cilës i përket funksioni apo pozita, ashtu siç është përcaktuar në shtojcat e këtij ligji".

Neni 7 paragrafi 1 dhe 3, përcakton se: "1.Paga llogaritet çdo muaj, nga institucioni përkatës, në raport me orarin e përcaktuar të punës, konkretisht në raport me orët e realizuara të punës dhe rregullat e përcaktuara përgjatë këtij ligji dhe ligjit përkatës për zyrtarët publik si dhe legjislacionin relevant në fuqi. 3. Vlera e pagës bazë (v), për punën e kryer me orar të plotë, llogaritet duke shumëzuar koeficientin për orë pune (x), më orët e realizuara përgjatë muajit (y), me vlerën monetare të koeficientit (z)".

Neni 9 paragrafi 1, përcakton se: "Vlera monetare e koeficientit përcaktohet me ligjin vjetor të buxhetit. Përcaktimi i vlerës së koeficientit bëhet në pajtim me legjislacionin për menaxhimin e financave publike".

Neni 14, përcakton se: "1. Paga bazë e nëpunëses/it civil është paga që përfiton nëpunësja/i civil për punën e kryer në një pozitë të caktuar apo për një klasë të caktuar dhe korrespondon me punën e kryer brenda orarit të plotë të punës gjatë një (1) muaji. 2. Paga bazë e nëpunëses/it civil përcaktohet sipas klasës së pagës, përkatësisht koeficientit, të cilit i përket pozita e punës e përcaktuar në shtojcën Nr. 10 të këtij ligji. 3. Klasifikimi i një pozite të caktuar të shërbimit civil, bëhet në bazë të rregullave të vlerësimit dhe klasifikimit të pozitave të punës, sipas dispozitave për klasifikimin e pozitave të shërbimit civil, në pajtim me legjislacionin në fuqi për zyrtarët publik".

Kolegji i Këshillit, duke marr për bazë dispozitat cekura me lartë, si dhe dëshmitë e lëndës, konstaton se pozita që mban ankuesja është klasifikuar në kategorinë/klasën profesional 1, dhe për rrjedhojë sipas shtojcës me Nr.3.2 të Ligjit Nr. 08/L-196 Për Pagat në Sektorin Publik, tek pozitat e klasës profesional 1 P14 koeficienti është përcaktuar 5.85, ngase e njëjta është e punësuar administratën e Prokurorisë.

Kolegji i Këshillit, konstaton se sipas nenit 6 të Ligjit Nr. 06/L-021 për Kontrollin e Brendshëm të Financave Publike, është përcaktuar se: "Drejtuesit e niveleve në vartësi të subjektit të sektorit publik, të cilët ushtrojnë funksione të përgjithshme menaxheriale, dhe të cilët kanë llogaridhënie menaxheriale, janë përgjegjës dhe raportojnë sipas shkallës hierarkike, deri tek zyrtari kryesor administrativ i subjektit të sektorit publik për procesin e buxhetit, statusin e sistemeve të kontrollit të brendshëm, rreziqet që parandalojnë përmbushjen e objektivave dhe masat e ndërmarra për minimizimin e tyre në institucionin që drejtojnë", ndërsa sipas nenit 17.1. të Ligjit Nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, është përcaktuar se: "17.1 Paratë publike do të përdoren vetëm për qëllime të miratuara publike. Asnjë autoritet publik, organizatë buxhetore, person apo ndërmarrje nuk mund të devijojnë, keq zbatojnë, ekspozojnë apo të përdorin në mënyrë të pa rregullt paratë publike", rrjedhimisht duke pasur parasysh nivelit e koeficienteve të përcaktuar me

dispozitat e Ligjit Nr. 08/L-196 Për Pagat në Sektorin Publik dhe duke pasuar parasysh ndarjen e mjeteve buxhetore për kategorinë për pagat të ndarë sipas ligjit vjetor të buxhetit, atëherë sipas Kolegji të Këshillit, edhe pagat e nëpunësve civil duhet të realizohen në pajtim me Ligjin Nr. 08/L-196 Për Pagat në Sektorin Publik dhe koeficientet e përcaktuar, rrjedhimisht edhe në rastin konkret të ankueses janë bërë korrigjimet në kuadër të dispozitave ligjore në fuqi dhe mbi këtë bazë, institucioni punëdhënës ankueses nuk i ka cenuar ndonjë të drejtë që ka të bëjë me pagën e saj, kështu që të gjitha pretendimet e ankueses janë të pabazuara, ngase edhe pas muajit mars ankuesja përveç koeficientit 5.85 realizon edhe shtesën tranzitore prej 291.70 Euro siç parashihet me dispozitat e 41 të Ligjit Nr. 08/L-196 Për Pagat në Sektorin Publik, ngase ankuesja para hyrjes në fuqi të këtij ligjit kishte koeficientin 13 me ekuivalentim të vjetër të pagave.

Duke marr parasysh konstatimet si më lartë, përkrahimin e detyrave të punës së pozitë së ankueses, Kolegji i Këshillit, nuk ka gjetur bazë ligjore se pozita e ankueses mund të kategorizohet në kategorinë e Ekspertëve në administratën e Prokurorisë kështu që pretendimet e ankueses janë të pabazuara.

Sa i përket vendimit të kundërshtuar me ankesë, respektivisht Vendimit KA.Nr.30/23 të datës 06.09.2023 të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Sekretariatit të Këshillit Prokurorial të Kosovës, Kolegji i Këshillit, konstaton se pika II e dispozitivit të këtij vendimi, është në kundërshtim të plotë me Vendimin me numër A.nr.907/2023 të datës 17.08.2023 të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, sepse nuk mund të lihet një fuqi një vendim i cili është shfuqizuar nga një organ i shkallës më të lartë respektivisht nga Këshilli, ngase vendimi i Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës sipas nenit 21 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës është vendim i formës së prerë, ndërsa kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, brenda afatit të përcaktuar me dispozitat e ligjit për konfliktin administrativ siç parashihet me nenin 22 të këtij ligji, si rrjedhojë Kolegji i Këshillit, konstaton se Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Sekretariatit të Këshillit Prokurorial të Kosovës në mënyrë të gabuar ka vendosur si në pikën II të dispozitivit të Vendimit KA.Nr.30/23 të datës 06.09.2023, po ashtu në arsyetim të këtij vendimi është komentuar respektivisht është kontestuar vendimmarrja nga ana e Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës sipas Vendimit me numër A.nr.907/2023 të datës 17.08.2023, kështu që nisur nga konstatimi si më lartë, Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave i Sekretariatit të Këshillit Prokurorial të Kosovës nuk ka as mandat por edhe as autorizim ligjor të komentoj vendimet e një organi më të lartë administrativ të përcaktuar me Kushtetutën e Republikës së Kosovës.

Ndërsa sa i përket pikës I të dispozitivit të Vendimit KA.Nr.29/23 të datës 06.09.2023 të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Sekretariatit të Këshillit Prokurorial të Kosovës, Kolegji i Këshillit, konstaton se i njëjti është në pajtim me gjendjen faktike dhe juridike siç e kemi arsyetuar në arsyetimin e lartcekur të këtij vendimi.

Andaj, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar nën 6 paragrafi 1, nën paragrafi 1.1 si dhe nën 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbiqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji i Këshillit vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Këshillë juridike: Pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër, A.nr.1211/2023

Ilire MEHMETI-SHAQIRI

Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional

Malsore GASHI-BAJRAKTARI

Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- Përfaqësuesit të ankuesit
- Drejtorit të Përgjithshëm në Sekretariatit e Këshillit Prokurorial të Kosovës;
- Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Sekretariatit të Këshillit Prokurorial të Kosovës;
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në Sekretariatit e Këshillit Prokurorial të Kosovës; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.